



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 17058 Prot

Vlorë, më 21.08. 2026

Lënda: Njoftim për mbledhjen e radhës të Këshillit të Bashkisë, datë **27.08.2026**.

ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE

Për dijëni: **KRYETARIT TË BASHKISË VLORE**
Znj. Brunilda Mersini

PREFEKTIT TË QARKUT VLORE
Znj. Evis Allushi

Ju njoftoj se, **ditën e enjte , datë 27.08.2026, ora 10:00**, në Pallatin e Kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhja e radhës të Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryesia e Këshillit, në bazë të Ligjit Nr. 139/2015, neni 53 pika 4 ku pas;

1. Shprehje për ligjshmërisë e VKB Nr 72 – 79, datë 21.07.2026.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, për muajin korrik, datë 21.07.2026,

Do të vazhdojmë me këtë rend dite:

1. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Korrik 2026”.
2. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Korrik 2026”.
3. Projektvendim “Për miratimin e subvencionit të qirasë që përfitojnë familjet në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë me të ardhurat e tyre qiranë e tregut të lirë”.
4. Projektvendim “Për një shtesë në VKB Nr 100, datë 23.12.2025 “Për buxhetin e bashkisë për vitin 2026, i ndryshuar”, sipas Aktit Normativ Nr 2, datë 30.06.2026 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026””.

5. Opinion mbi projektligjin “Për Ndarjen Administrativoterritoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”.
6. Të ndryshme.

Kryesia e Këshillit të Bashkisë, u mbledh në mjediset e Bashkisë Vlorë ditën e premte, datë 21.08.2026, ora 10:00.

Komisionet e përhershme, do të mbledhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :

Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike, do të mbledhet ditën e martë, datë 25.08.2026, ora 09:00.

Komisioni i shërbimeve publike, transportit, infrastrukturës dhe strehimit, do të mbledhet ditën e martë , datë 25.08.2026, ora 10:00

Komisioni për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet, do të mbledhet ditën e martë, datë 25.08.2026, ora 11:00.

V.O. Bazuar në rendin e ditës të sipërcituar, nëse ndonjë nga Komisionet e Përhershme, vlerëson se, duhet të mbledhet për çështjet që trajtojnë projektvendimet, Kryetari i Komisionit të njoftojë anëtarët e komisionit përkatës, për datën dhe orën e mbledhjes.

KRYETAR
Elpiniqi Mërkuri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 17057 Prot.

Vlorë, më 21.8. 2026

VENDIM

Nr 9, datë 21.08.2026.

“MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS” (Ora 10:10)

Në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 53, Neni 56, pika 2/a dhe, Rregulloren “Për Organizmin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë” Neni 58 dhe 59, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës 21.08.2026,

VENDOSI:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Vlorë, e cila do të mbahet në datën **27.08.2026**.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit dhe, në mungesë të tij, Kryetari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Vlorë, Deputetët e Bashkisë Vlorë dhe personat apo/dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te Kryetari i Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elpiniqi Mërkuri

